



SACP Programme

*Programi i mbështetjes Suedeze për Ministrinë e Brendshme / PSH për policimin në komunitet*

---

# STUDIM MBI MATJEN E SIGURISË NË KOMUNITET

RAPORTI FINAL

20 NËNTOR 2013

## PERMBAJTA

<b>1. Qëllimi i Projektit.....</b>	<b>5</b>
Situata e përgjithshme .....	5
<b>2.PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>6</b>
<b>3. REZULTATET.....</b>	<b>12</b>
3.1. Demografia.....	12
3.2. Rezultatet – të përgjithshme dhe specifike në pesë qytete. ....	15
A. Sa serioze i konsideroni problemet e mëposhtme në zonën tuaj? .....	15
A.1.Ndotja e Ambjentit .....	15
A.5 .Prishja e rendit publik dhe sherret/përleshjet në rrugë .....	19
A.7. Veprimtaria e bandave të të rinjve dhe & A.8. Zhurmat nga baret dhe të tjera ambjente argëtimi .....	21
A.9. Shpejtësia e lëvizjes së makinave përtej limitit të lejuar dhe A.10. Thyerja e rregullave të trafikut të tilla si mosrespektimi i dritave të trafikut, mosrespektimi i kalimtarëve, parkim i gabuar, etj. ....	23
B. EKSPLOZIMI NDAJ KRIMIT .....	24
B.1. Frekuencat në përgjigjet e dhëna .....	27
B.2. Raportimi tek policia lidhur me krimet dhe dhunimet .....	27
C.SHQETËSIMET LIDHUR ME SIGURINË DHE RENDIN NË KOMUNITETIN E TYRE DHE ZONAT KU BANOJNË .....	29
D. PERCEPTIMI I FRIKËS DHE PASIGURISË .....	32
<b>E. KËNAQËSIA ME PUNËN E POLICISË NË KOMUNITET .....</b>	<b>34</b>
<b>SHTOJCA.....</b>	<b>37</b>
1.METODOLOGJIA .....	37
2.1. Përcaktimi i kampionit të anketimit – qasja e anketimit personal në banesë.....	37
2.2. Pyetësi i anketimit .....	38
2.3. Mbledhja e të dhënave dhe hedhja e tyre në programin SPSS .....	39
2.– Lista e Qyteteve dhe Shpjegimi i Zonave .....	41
3- Hartat e Qyteteve dhe Zonave.....	42
TIRANA.....	42
DURRËSI .....	43
LEZHA.....	45
VLORA .....	46
ELBASANI .....	48

## LISTA E SHKURTIMEVE

ASP	Policia e Shtetit Shqiptar
CBTL	Qendra për Biznes Teknologji dhe Lidërsip
ICLA	Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri
LSMS	Sistemi për Matjen e Sigurisë në Komunitet
PMT	Ekipi i Menaxhimit të Programit
QBTD	Qendra e Biznesit Teknologjisë dhe Drejtimit
SACP	Mbështetja Suedeze për MB/PSH për Policimin në Komunitet
SPSS	Paketa Statistikore për Shkencat Sociale

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1- numri i të anketuarve për zona dhe qytete .....	12
Tabela 2- Etnia e të anketuarve për çdo qytet .....	12
Tabela 3 - Koha që kanë banuar në atë zonë.....	13
Tabela 4 - Niveli i arsimit të anketuarve .....	14
Table 5 - Niveli i punësimit.....	14
Tabela 6 - Sa të kënaqur kanë qenë nga kontaktet me policinë .....	36

## LISTA E TË DHËNAVE

Figure 1 - Tabela Përmbledhëse e rezultateve të 5 Qyteteve - 10 zonave.....	8
Figure 2 - Ndotja e Ambientit sipas qyteteve .....	15
Figure 3- Ndotja e Ambientit sipas gjinisë .....	16
Figure 4-. Cënimi i pronës publike apo private sipas qyteteve.....	16
Figure 5 - Cënimi i pronës publike apo private sipas gjinisë.....	17
Figure 6 - Dehja në ambiente publike sipas qyteteve .....	17
Figure 7 - Dehja në ambiente publike sipas gjinisë .....	18
Figure 8- Shpërndarja dhe përdorimi i drogës në vende publike sipas qyteteve.....	18
Figure 9 - - Shpërndarja dhe përdorimi i drogës në vende publike sipas gjinisë.....	19
Figure 10 - Prishja e rendit publik dhe sherret/përleshjet në rrugë sipas qyteteve .....	19
Figure 11- Prishja e rendit publik dhe sherret/përleshjet në rrugë sipas gjinisë .....	20
Figure 12- Ngacmimi i grave dhe vajzave në ambiente publike sipas qyteteve.....	20
Figure 13- Ngacmimi i grave dhe vajzave në ambiente publike sipas gjinisë.....	21

Figure 14- . Veprimtaria e bandave të të rinjve sipas qyteteve .....	21
Figure 15 - Veprimtaria e bandave të të rinjve sipas gjinisë.....	22
Figure 16 - Zhurmat nga baret, lokalet dhe të tjera ambiente sipas qyteteve.....	22
Figure 17 - Zhurmat nga baret, lokalet dhe të tjera ambiente sipas gjinisë.....	23
Figure 18 - Viktimë e dhunës fizike .....	24
Figure 19 - Viktimë e dhunës fizike - Nëse PO, Ku ndodhi?.....	25
Figure 20 - Viktimë e vjedhjes.....	25
Figure 21 - viktimë e cënimit të pronës .....	26
Figure 22 - Gjatë 12 muajve të fundit a keni raportuar në polici ndonjë veprim kriminal ndaj jush? .....	27
Figure 23 - A ju kërkoi policia deklaratë apo kallëzim me shkrim në këto raste që raportuat?.....	28
Figure 24 - Gjatë 12 Muajve të fundit keni evituar pjesëmarrjen në aktivitete publike .....	33
Figure 25- Gjatë 12 muajve të fundit sa jeni ndier të pasigurt në përdorimin e transportit publik?.....	34
Figure 26 - Sa jeni dakort me pohimin se policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën tuaj të banimit? .....	35
Figure 27 - Keni pasur kontakte me policinë & Figure 28 - Ku jeni takuar me policinë .....	35
Figure 29 - Harta e Tiranës me 2 zonat.....	42
Figure 30 - Tirana Zona 1 .....	42
Figure 31 - Tirana Zona 2 .....	43
Figure 32 - Harta e Durrësit me 2 Zonat .....	43
Figure 33 - Durrës Zona 1.....	44
Figure 34 - Durrës Zona 2.....	44
Figure 35 - Harta e Lezhës me 2 Zonat .....	45
Figure 36 - Lezha Zona 1 .....	45
Figure 37 -Lezha Zona 2 .....	46
Figure 38 - Harta e Vlorës me 2 Zonat .....	46
Figure 39 - Vlora Zona 1 .....	47
Figure 40 - Vlora Zona 2 .....	47
Figure 41- Harta e Elbasanit me 2 Zonat .....	48
Figure 42 - Elbasan Zona 1 .....	48
Figure 43 - Elbasan Zona 2 .....	49

## 1. QËLLIMI I PROJEKTIT

Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet (LSMS) fokusohet në dy drejtime:

- a) Të masë sesi perceptohet nga komuniteti niveli i sigurisë, përfshirë këtu nivelin e krimit, problemet me rendin, si dhe sigurinë në trafikun rrugor.
- b) Të masë nivelin e kënaqësisë së komunitetit ndaj punës së policisë në 10 zona të përcaktuara në 5 qytete, përkatësisht në Tiranë, Lezhë, Elbasan, Durrës dhe Vlorë (dy zona të ndryshme për çdo qytet).

Matja e perceptimit të nivelit të sigurisë është kryer në kuadër të Programit të mbështetjes Suedeze për Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit për policimin në komunitet. Programi ka kontraktuar dy organizata të specializuara për këtë lloj shërbimi: 1. Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri dhe 2. Qendra e Biznesit, Teknologjisë dhe Drejtimit.

### Situata e përgjithshme

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përfshin policinë e rendit publik, policinë e hetimit të krimit, policinë kufitare, policinë e trafikut rrugor, njësitë e forcave speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë dhe drejtoritë e personelit, logjistikës dhe buxhetit. Janë 12 Drejtori Policie në nivel qarku, 43 komisariate dhe 8 Drejtori Rajonale të Kufirit dhe Migracionit.

Inspektorët e zonës janë ata që janë të vendosur më afër komunitetit dhe marrin përgjegjësi të përditshme sipas aktiviteteve të policimit në komunitet në terren. Ata janë lidhja direkte me kryetarin e bashkisë ose komunës dhe gjithashtu marrin pjesë, kur u kërkohet, në takimet lokale që organizohen në kuadër të policimit në komunitet.

Qasja e Policisë së Shtetit për Policimin në Komunitet dhe implementimin e Planit të Veprimit bazohet në Nenin 122 të Ligjit për Policinë e Shtetit, nr.9749, datë 04.06.2007. Sipas këtij ligji Policia e Shtetit është e detyruar të konsultohet në nivele të ndryshme me partnerët dhe grupet e interesit kur përgatit planet vjetore të policimit sipas zonave. Për më tepër, Policia e Shtetit e ka përshtatur Policimin në Komunitet si një element gjithëpërfshirës në Strategjinë 7-vjeçare të Policisë së Shtetit 2007 – 2013, duke u fokusuar në këto 6 elementë kryesorë: Parandalimi i krimit; Zgjidhja e problemeve; Bashkëpunimi; Shërbimet e Inteligjencës; Veprimtari e orientuar nga planifikimi strategjik dhe Aktivitete të bazuara në kosto.

Strategjia e vë theksin veçanërisht në “identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve, vizibilitetin dhe aksesin nga individët të shërbimeve të policisë dhe cilësinë e shërbimeve”. Gjithashtu është përgatitur dhe një plan specifik veprimi i Policimit në Komunitet për 2011 – 2013 (bazuar në planin e veprimit 2008 – 2010), i cili identifikon një numër iniciativash, institucionet përgjegjëse dhe afatet e zbatimit.

## 2. PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

"Brianna lëshoi patinën para këmbëve të Samit ..... "Mos u shqetëso, Unë nuk do të lë të biesh."

"Po? - tha Sami.. "Atëherë pse ke sjellë kaskë?"

Brianna i hedh kaskën Samit për ta kapur ..... "Në rast se rrëzohesh."

- **Michael Grant, "Uria"**<sup>1</sup>

Policimi në komunitet është në të njëjtën kohë edhe një filozofi (një mënyrë e të menduarit) dhe një strategji organizative (një mënyrë e kryerjes së filozofinë), që lejon policinë dhe komunitetin të punojnë së bashku në mënyra të reja për të zgjidhur problemet e krimit, rendit dhe sigurisë për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë në këtë komunitet. Policimi në komunitet është një nga çështjet më të rëndësishme të vendosura në prioritetet e Policisë së Shtetit Shqiptar. Dhe për komunitetin në përgjithësi përfshirë banorët, bizneset, shkollat etj, siguria është një çështje prioritare. Siguria dhe pasiguria ndikon në mënyra të ndryshme mbi jetën socio-ekonomike të komunitetit përfshirë perceptimet mbi sigurinë fizike, mjediset të sigurta të jetesës përfshirë aktivitetet ekonomike, kulturore apo sociale, etj.

1. Si një nga ofruesit kryesorë të sigurisë, policia duhet të luajë një rol kryesor në krijimin e kushteve në të cilat komuniteti percepton siguri në ambientin ku jeton dhe ndërvepron. Gjithsesi ata që preken ose ndikohen më shpesh nga ndjenja e sigurisë në veprimet dhe sjelljet e tyre kanë pak mundësi për t'u përballur, takuar ose angazhuar në mënyrë konstruktive me policinë. Kjo mund të rezultojë shumë shpesh në ndjenja mosbesimi që komuniteti tregon ndaj policisë dhe punës që ajo kryen në komunitetet ku punonjësit e policisë shërbejnë.
2. Qëllimi i këtij studimi është a) Të masë sesi perceptohet nga komuniteti niveli i sigurisë, përfshirë këtu nivelin e krimit, problemet me rendin, si dhe sigurinë në trafikun rrugor dhe b) Të masë nivelin e kënaqësisë së komunitetit ndaj punës së policisë në 10 zona të përcaktuara në 5 qytete, përkatësisht në Tiranë, Lezhë, Elbasan, Durrës dhe Vlorë (dy zona të ndryshme për çdo qytet).
3. Anketimi për këtë raport u realizua në 5 qytete: Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Lezhë dhe në dy zona të përcaktuara "pilot" në çdo qytet (10 zona në total)<sup>2</sup>. Gjithsej u realizuan 2000 intervista të vlefshme me një numër prej 200 intervistash për zonë. Përzgjedhja e personave në këtë anketim u mbështet në metodën e "anketimit personal në banesë".<sup>3</sup>
4. **Mosha** e personave që u përgjigjën ishte mjaft e balancuar: 20.6 % e të intervistuarve ishin të moshës 18-29 vjeç; 25.4% ishin 30-39 vjeç; 27.5% ishin 40-49 vjeç dhe 26.6% ishin mbi 50 vjeç. Për sa i përket **Gjinisë** 55.6 % e personave që u përgjigjën ishin femra dhe 44.4 % ishin meshkuj. Për sa i përket **Etnisë** të personave që u përgjigjën ajo varion më së shumti nga Shqiptar, e ndjekur nga Egjiptianët, Romët dhe Grekët. Për sa i takon **kohës në të cilën të intervistuarit jetonin në zonat respektive** mund të thuhet se më shumë se gjysma e të intervistuarve ishin mjaft stabilë në vitet në të cilat kishin jetuar në atë komunitet në kohën e anketimit. Për sa i takon **nivelit të edukimit** 52.6% e të intervistuarve kishin

<sup>1</sup> Michael Grant është shkrimtar amerikan i ditëve të sotme, ka shkruar mbi 150 libra, Libri origjinal "Hunger" shkruar në 2009

<sup>2</sup> Shiko Shtojcën 3 për hartat e detajuara të zonave

<sup>3</sup> Shiko Shtojcën 1 - Metodologjia

mbaruar shkollën e mesme ndërsa 21.6% ishin me një diplomë universiteti dhe për sa i takon **statusit të punës**, 45.1% e të intervistuarve ishin ndërkohë në punë ndërsa 55.0% ishin të papunë ose në pension.

- Në bazë të rezultateve të detajuara si dhe tabelës përmbledhëse paraqitur më poshtë me ngjyra, mund të themi se ka shumë çështje për të cilat Policia e Shtetit mund të reflektojë dhe nxjerrë konkluzione si për të përmirësuar punën e saj ashtu dhe perceptimin mbi sigurinë që banorët kanë në komunitet ashtu dhe mbi punën e policisë.
- Lezha dhe Elbasani ndjekur shpesh dhe nga Vlora e Durrësi, janë qytetet që reflektojnë shqetësimet më të mëdha të popullsisë në lidhje me sigurinë e tyre, duke përfshirë këtu nivelet e krimit, problemet me rendin si dhe sigurinë në trafikun rrugor apo kënaqësinë në lidhje me punën e policisë.**

Anketa - Studimi mbi sigurinë e bashkësisë lokale dhe kënaqësisë ndaj shërbimit policor	Niveli Kombëtar	Tirana		Durrësi		Elbasani		Lezha		Vlora		Mesatarja	Kufiri me i Ulet	Kufiri me i larte
		Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2			
<b>Sa serioze i konsiderojnë qytetarët e anketuar problemet e mëposhtme në zonat e tyre:</b>														
Q_1A Ndotja e mjedisit	83.5	89.0	63.5	57.5	49.0	98.0	85.0	98.0	97.0	98.5	99.5	83.5	82.1	84.9
Q_1B Cënimi i pronës private apo publike	66.1	72.5	56.5	47.5	57.5	85.0	13.5	99.5	99.5	87.0	42.5	66.1	64.4	67.8
Q_1C Njerëz të dehur në vende të hapura publike, si rrugë, sheshe, etj.	61.9	56.5	41.5	36.0	27.5	89.5	83.0	98.5	95.0	37.5	54.0	61.9	60.1	63.7
Q_1D Shpërndarja apo përdorimi i drogës në vende publike si rrugë, sheshe, shkolla, bare, etj.	58.3	53.0	39.5	32.0	30.0	88.0	71.0	95.5	94.5	68.0	11.0	58.3	56.4	60.1
Q_1E Prishje e rendit publik dhe përlëshje në rrugë	58.6	48.5	44.0	38.5	38.0	88.0	78.0	96.0	94.5	40.5	20.0	58.6	56.8	60.4
Q_1F Ngacmimi i femrave në mjedise publike	56.3	47.5	48.0	27.5	28.5	74.0	36.5	95.0	96.5	61.0	48.5	56.3	54.5	58.1
Q_1G Aktiviteti i bandave të të rinjve	47.8	53.0	43.5	37.0	29.0	75.0	5.0	98.0	97.5	37.5	2.5	47.8	46.0	49.6
Q_1H Zhurma nga lokalet apo vendet të tjera argëtuese	54.5	62.0	52.0	39.5	39.0	84.0	37.5	99.5	97.0	19.5	15.0	54.5	52.7	56.3
Q_1I Lëvizja e makinave me shpejtësi përtej normës së lejuar	82.5	82.0	67.0	65.5	41.0	94.5	98.0	100.0	100.0	98.5	78.0	82.5	81.0	83.9
Q_1J Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, si kalimi me të kuqe, mos respektimi i kalimtarëve, parkimi i gabuar, etj.	81.8	76.5	69.5	73.5	39.0	97.5	84.0	100.0	100.0	98.5	79.0	81.8	80.3	83.2
<b>Ekspozimi ndaj krimit</b>														
Gjatë 12 muajve të fundit, a kanë qenë ndonjëherë qytetarët e anketuar:														
Q_2 Viktimë e dhunës fizike?	3.6	5.5	5.3	7.5	.5	1.0	7.5	2.0	1.5	5.0	.5	3.6	2.9	4.3
Q_4 Viktimë e vjedhjes / grabitjes?	16.1	6.5	8.8	16.0	19.0	21.5	7.0	23.0	24.0	30.0	3.0	16.1	14.7	17.5
Q_6 Viktimë e dhunimit të pronës?	10.6	2.5	3.8	15.5	16.5	17.5	4.0	15.5	20.0	9.0	.5	10.6	9.5	11.7
Q_8 Viktimë e një veprimi tjetër kriminal?	5.1	1.0	3.8	8.0	8.0	2.0	2.5	8.5	13.0	1.0	.5	5.1	4.3	5.9
Q_9 Gjatë 12 muajve të fundit a keni raportuar në polici ndonjë veprim kriminal?	4.4	.0	1.8	7.5	7.5	1.5	1.0	8.5	13.0	1.0	.0	4.4	3.6	5.1

Gjatë 12 muajve të fundit, a kanë qenë ndonjëherë qytetarët e anketuar të shqetësuar :	Niveli Kombëtar	Tirana		Durrësi		Elbasani		Lezha		Vlora		Mesatarja	Kufiri me i Ulet	Kufiri me i larte
		Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2			
Q_12A Se mund tu hynin forcërisht për të vjedhur në banesë?	38.1	31.5	16.5	15.5	27.0	55.5	7.0	83.5	95.0	35.0	15.0	38.2	36.4	39.9
Q_12B Se mund të binin viktimë e krimit në mjediset e përbashkëta të banimit, si shkallë, ashensor, apo garazh?	36.5	29.0	31.0	17.0	24.5	52.5	4.5	94.5	95.5	9.0	7.0	36.5	34.7	38.2
Q_12C Se mund ti vidhnin apo dëmtonin makinën, motorin apo biçikletën e parkuar pranë zonës së banimit?	41.0	31.5	37.0	25.5	21.5	58.0	6.5	98.0	99.0	21.0	11.5	41.0	39.1	42.8
Q_12D Mund të binin viktimë e dhunës në zonën pranë banesës?	37.4	29.0	31.0	25.5	21.5	52.0	3.0	97.5	98.0	8.0	9.0	37.5	35.7	39.2
Q_12E Për sigurinë e fëmijëve në zonën e tyre të banimit?	58.9	42.0	42.5	51.0	27.5	65.0	83.0	99.0	99.0	39.5	40.5	58.9	57.1	60.7

A ndihen konkretisht të pasigurt qytetarët e anketuar:	Niveli Kombëtar	Tirana		Durrësi		Elbasani		Lezha		Vlora		Mesatarja	Kufiri me i Ulet	Kufiri me i larte
		Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2			
Q_13 Kur dalin në errësirë në zonën pranë banesës?	27.3	27.0	35.5	43.5	58.5	30.0	13.0	.5	1.0	46.0	17.5	27.3	25.6	28.9
Q_13 Kur ecin në errësirë në zonën e tyre të banimit?	44.0	38.0	25.0	13.5	12.5	40.5	33.5	96.0	93.5	26.0	61.0	44.0	42.1	45.8
Q_14 Sepse kanë frikë nga ndonjë person në zonën e tyre të banimit?	18.7	14.5	6.0	42.0	15.0	9.0	56.0	13.0	17.5	9.0	4.5	18.7	17.2	20.1
Q_15A Kanë shmangur pjesëmarrjen në aktivitete sportive për shkak të pasigurisë apo frikës së mund të keqtrajtoheshin apo të binin pre e vjedhjes apo e dhunës?	13.1	2.0	.5	.5	1.0	4.5	3.0	60.5	52.5	4.5	1.5	13.1	11.8	14.3
Q_15B Kanë shmangur vajtjen në kinema, teatër apo veprimtari të tjera kulturore-artistike për shkak të pasigurisë apo frikës së mund të keqtrajtoheshin apo të binin pre e vjedhjes apo e dhunës?	4.8	.0	2.5	2.0	1.5	6.0	6.5	11.5	15.5	2.5	.0	4.8	4.0	5.6
Q_15C A kanë shmangur ata frekuentimin e bareve, restoranteve apo vendeve të tjera argëtuese për shkak të pasigurisë apo frikës së mund të keqtrajtoheshin apo të binin pre e vjedhjes apo e dhunës?	14.6	1.0	5.5	3.5	2.0	6.0	8.5	62.5	50.5	4.5	1.5	14.6	13.3	15.8
Q_15D A kanë shmangur ata pjesëmarrjen në aktivitete publike për shkak të pasigurisë apo frikës së mund të keqtrajtoheshin apo të binin pre e vjedhjes apo e dhunës?	20.4	7.5	11.5	3.0	2.5	6.5	38.5	63.0	53.0	10.0	8.5	20.4	18.9	21.9
Q_15E Kanë shmangur përdorimin e transportit publik për shkak të pasigurisë apo frikës së mund të keqtrajtoheshin apo të binin pre e vjedhjes apo e dhunës?	32.9	23.0	24.5	33.0	7.5	8.0	48.5	76.5	60.0	35.0	12.5	32.9	31.1	34.6
Q_16.1 Policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën time të banimit: <b>DAKORT</b>	51.5	72.5	66.5	69.0	82.0	50.5	48.0	13.5	3.0	78.5	31.5	51.5	49.7	53.3
Q_16.2 Policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën time të banimit: <b>Jo-DAKORT</b>	48.5	27.5	33.5	31.0	18.0	49.5	52.0	86.5	97.0	21.5	68.5	48.5	46.7	50.3
Q_19.1 Të pakënaqur nga kontaktet personale me policinë *	39.6	21.1	30.0	48.4	32.5	40.7	.0	60.9	76.9	40.5	26.5	39.6	34.9	44.4
Q_19.1.1. Të kënaqur nga kontaktet personale me policinë *	36.8	57.9	50.0	22.6	50.0	29.6	50.0	21.7	7.7	40.5	44.1	36.8	32.1	41.6
Q_19.2 Të pakënaqur nga kontaktet personale me policinë **	5.7	2.0	1.5	7.5	6.5	5.5	.0	7.0	10.0	7.5	9.0	5.7	4.8	6.5
Q_19.2.1 Të kënaqur nga kontaktet personale me policinë **	5.3	5.5	2.5	3.5	10.0	4.0	1.0	2.5	1.0	7.5	15.0	5.3	4.4	6.1

Figure 1 - Tabela Përmbledhëse e rezultateve të 5 Qyteteve - 10 zonave

\* Konsideruar vetëm personat që kanë pasur kontakt me policinë

\*\* Konsideruar të gjithë personat e anketuar

7. Tabela e mësipërme na jep një përmbledhje të çështjeve problematike sipas qyteteve dhe zonave dhe na jep një ide përmbledhëse mbi sa problematike janë ose perceptohen çështjet nga komuniteti ku u krye anketimi. (P.sh nëse një çështje perceptohet serioze dhe shumë serioze, ose të anketuarit mbi një temë ndihen të pasigurt dhe shumë të pasigurt ose nëse një krim ose veprim i rrezikshëm ndodh shpesh dhe shumë shpesh).

**Ngjyra e verdhë** na tregon mesataren e nivelit kombëtar siç mund të dilte duke u bazuar mbi të dhënat e marra nga 2000 ( dy mijë ) të anketuar në 5 ( pesë ) qytete dhe 10 zona duke marrë në konsideratë vetëm përgjigjet problematike. ( Ngjyra e verdhë do të lexohet: Mesatarisht në 5 qytetet e hulumtuara, në bazë të studimit të një popullsie prej 2000 të anketuarish, sikur të konsideronim gjithë banoret e këtyre 5 qyteteve , rreth 90% e tyre mesatarisht do të pohonin një nga vlerat e kolonës 1 me të verdhë.) P.sh. në nivel kombëtar ( 5 qytetet me një popullatë prej më shumë se 1.2 mil banorë gjithsej) në bazë të të dhënave të mbledhura për 2000 anketues, do të gjenim që 90% e tyre do të pohonin mesatarisht që 83.5% e tyre e kanë problem ndotjen e mjedisit ( Q1.A), ose 51.5% e tyre mesatarisht do të binin dakord që policia kujdeset për problemet e rendit publik ( Q16.1)

**Kufiri më i ulët dhe kufiri më i lartë** - Dy kolumnat e fundit në të djathtë të tabelës së mësipërme. Tregon marzhin ose kufijtë e tolerancës së mesatares - p.sh. duke u bazuar në pohimin më sipër detajet do ishin - " Në nivel kombëtar ( 5 qytetet me një popullatë prej më shumë se 1.2 mil banorë gjithsej) në bazë të të dhënave të mbledhura për 2000 anketues, do të gjenim që 90% e tyre do të pohonin midis minimumi 82.1 % - dhe maksimumi 84.9% e tyre se e kanë problem ndotjen e mjedisit ( Q1.A), ose diku midis 49.7% me 53.3% e tyre do të binin dakord që policia kujdeset për problemet e rendit publik ( Q16.1)



**Ngjyrat në mes të tabelës me të gjelbërt dhe të kuqe** - Çdo diferencë më e vogël në shifra ose përqindje se minimumi i marzhit ( kufiri më i ulët i 90% e popullsisë që do përgjigjej mesatarisht në nivel vendi) - do e vendoste zonën në ngjyrën e gjelbër dhe çdo diferencë më e madhe se maksimumi i marzhit ( kufiri më i lartë i 90% të popullsisë që do përgjigjej mesatarisht në nivel vendi)- do e vendoste zonën në të kuqe

8. Është për tu theksuar se ne kemi marrë **opinionet e cilat kanë shumë diferenca midis tyre në përgjigjet e dhëna brenda së njëjtës pyetje** ( p.sh. në të njëjtën zonë kemi në të njëjtën kohë pothuaj gjysmëm që nuk janë dakort me një çështje dhe gjysmën tjetër që janë dakort ose 37 % e të njëjtës zonë e konsideruan një problem shumë serioz, ndërsa në të njëjtën zonë 35 % e popullsisë nuk e konsiderojnë atë çështje aspak problem) prandaj kemi pak të verdha në rezultatet e zonave ose qyteteve ( ose ndryshe kemi pak rezultate të zonave që janë afër mesatares kombëtare).

Për të kuptuar më tej një ndryshim të tillë është e rëndësishme të analizohen edhe përgjigjet e pyetjeve demografike e të anketuarve (tabelat janë të gatshme dhe në dispozicion pranë Projektit SACP). Dallimi në përgjigje mund të jetë për shkak të dallimit në moshë, nivelit të arsimimit, statusit të punës, viteve që jetojnë në këtë zonë etj.

9. **Ky studim është i bazuar në të dhëna sasiore (kuantitative)** . Duke matur perceptimin e personave në mënyrë sasiore **ka çështje të cilat kanë nevojë të kuptohen dhe duke parë anën cilësore - PSE?** – Për shembull, nëse njerëzit nuk ndjehen të sigurtë të ecin në errësirë në zonën e tyre ( PO / JO ) pyetësi nuk e konsideron (PSE?). Nëse ne do ti kërkojmë arsytet të anketuarve, mund të marrim përgjigje për çështje që jo gjithmonë janë të lidhura me punën e policisë - përgjigjet mund të jenë për shembull ‘.. se rruga nuk është e shtruar ose se nuk ka ndriçues në rrugë ‘ të cilat mund të adresohen si probleme për pushtetin lokal.

10. Gjithsesi ne mendojmë që anketimi dhe metodologjia mund të përdoret si **bazë për të krijuar një barometër të mendimeve dhe perceptimeve të komunitetit mbi sigurinë, rendin dhe punën e policisë** në komunitete nëse do të përdoret si i tillë ndër vite.

11. Është me rëndësi të mos anashkalohet dhe faktori njerëzor në leximin e rezultateve (p.sh si janë ndier personat e anketuar në momentin që kanë plotësuar pyetësin dhe kanë dhënë përgjigjet).

12. Në analizimin e rezultateve - ne do të këshillojm **punonjësit e policisë që t'i marrin këto rezultate si një tregues të problemeve në komunitetet e tyre përkatëse dhe të reflektojnë pozitivisht mbi atë që mund të bëhet për të përmirësuar situatën duke u udhëhequr nga pyetje të tilla si:**
- ❖ Çfarë i bën njerëzit të ndjehen të pasigurtë në zonë?
  - ❖ Cili është roli që policia mund të luajë për të kontribuar më shumë në rritjen e sigurisë mbi këtë çështje?
  - ❖ Si mund të ndryshojmë perceptimet e komunitetit mbi rendin, sigurinë dhe punën e policisë në komunitet?
  - ❖ Etj
13. Në rezultatet e paraqitura tek Projekti SACP (përgjigjet e marra në anketim dhe tabulatet e tyre) vlen të theksohet se **janë gratë ato që në përgjithësi janë më të shqetësuara për sigurinë sesa burrat në të pesë qytetet e përzgjedhur**. Ne do të rekomandojm që në përpjekjet e ardhshme për të përmirësuar si perceptimin e komunitetit ndaj punës së policisë si perceptimin e komuniteti ndaj sigurisë që u ofrohet në zonat që banojnë , **një punë e veçantë të kryhet me gratë dhe nënat e familjeve**.
14. **Vlen gjithashtu të vërejmë se disa zona, të cilat janë perceptuar të jenë më problematike, nuk japin ndonjë rezultat për këtë çështje**. Për shembull 72 të anketuar u përgjigjën që të jenë viktimat të dhunës fizike me normat më të larta në zonën 1 në Durrës, Elbasan zona 2, dhe Tiranë të dy zonat. Është e paqartë nëse pjesa tjetër e zonave të tilla si Lezha dhe Vlora nuk përballen me një çështje të tillë apo nëse ata nuk ishin të gatshëm të jepnin përgjigje në një pyetje të tillë ( **një proces më i thellë cilësor do të ndihmonte në këtë aspekt**).
15. Në lidhje me përgjigjet e të qenit viktimat të krimit - Ky seksion i pyetësorit duhet të riformulohet sepse **është i paqartë dhe nuk është e mundur të kuptohet numri i vërtetë i rasteve në të cilat personat kanë qenë viktimat të krimit, për shkak të shumë opsioneve të përgjigjeve në pyetësor në lidhje me të njëjtën pyetje**. Ne do të propozojmë që kjo pyetje të riformulohet vetëm me një pyetje: "Në 12 muajt e fundit a keni qenë personalisht viktimë e çfarëdolloj krimi apo dhune fizike?"
16. **Pyetja në lidhje me ngacmimin e grave dhe vajzave** – Kjo pyetje vetëm mat perceptimin se sa serioze të anketuarit e konsiderojnë këtë çështje dhe nuk na tregon nëse në të vërtetë ekziston ngacmimi i grave dhe vajzave në hapësirat publike. Siç është formuluar pyetja ajo mund të kuptohet për të dyja rastet, edhe për të treguar perceptimin e të anketuarve, gjithashtu edhe për të treguar rastet aktuale. Pra duke qenë se përgjigjet e dhëna nuk na japin saktësisht sesa realisht ekziston dhe sa vetëm ai perceptohet si një problem potencial, është vështirë që edhe të adresohet dhe të trajtohet saktësisht.
17. Megjithatë pyetësori u testua përpara se të fillonte anketimi dhe rezultatet e testimit u konsideruan në versionin final të pyetësorit, **në përfundim të procesit ne do të rekomandojm disa ndryshime të**

**vogla në disa pyetje nëse pyetëtori do përdoret në të ardhmen si një mjet standard që do të masë ndryshimet në të njëjtat komunitete vit pas viti. ( Kjo bazuar dhe në komentete e bëra në pikat ( 14, 15. 16 më sipër)**

18. Në lidhje me rekomandimin në pikën 17, **në përmirësimin e pyetësorit** do të ishte me rëndësi që të shtoheshin dhe pyetje ndaj të anketuarve **(nëse ata janë vetë si komunitet në dijeni të konceptit të policimit në komunitet?)** si dhe pyetja se **(Sa këta banorë marrin pjesë aktive dhe bashkëpunojnë me policinë në policimin komunitar?)**. Kjo do ti jepte informacion atyre që merren me analizimin e të dhënave mbi njohuritë që ka komuniteti në lidhje me punën e policisë ne komunitete si dhe duke kuptuar se sa janë të angazhuar vetë anëtarët e komunitetit në policimin komunitar të kuptohet diferenca midis mendimeve aktuale mbi problematikat dhe perceptimeve ndaj këtyre problematikave.

Kjo do të ndihmonte punonjësit e policisë në marrjen e masave për të ndryshuar punën e tyre në komunitet ( p.sh nëse duhet ndryshuar puna e policisë me elementet problematikë të komunitetit në lidhje me krimet apo trazirat apo duhet ndryshuar strategjia e komunikimit me komunitetin duke qënë më viziv dhe të pranishëm)

19. **Në të ardhmen, nëse një anketim i ngjashëm do të ndërmerrej, do të rekomandonim një proces komunikimi përfshirje më të plotë midis hulumtuesve dhe ekipeve të Policisë që veprojnë në komunitetet ku sondazhi zhvillohet.** - Siç është vënë në dukje edhe në takimet me policinë gjatë paraqitjes së rezultateve paraprake, kishte shumë punonjës policie të cilët nuk ishin të informuar për procesin, pasi ata ishin emëruar kohët e fundit. Kjo mund të shkaktojë një distancim të tyre prej rezultateve dhe mungesë të përkatësisë mbi atë se si ata do të reflektojnë mbi rezultatet dhe gjetjet e anketimit. Në një numër të vogël rastesh, punonjësit e policisë nuk ishte mjaft mbështetës dhe bashkëpunues me anketuesit në terren në lidhje me kërkesa të thjeshta si kërkesa për ndihmë për të gjetur rrugët e zonës. Kjo mund të interpretohet se punonjësit e policisë ose ishin të rinj dhe nuk e njihnin zonën, ose ata nuk ishin familjarë me zonën / komunitetin që supozohet se duhet të mbulonin.

### 3. REZULTATET<sup>4</sup>

#### 3.1. Demografia

Një total prej 2190 banesash u vizituan gjatë një periudhe prej 10 ditësh në 10 zonat e përzgjedhura në 5 qytete (nga 2 zona për çdo qytet). Njëzetë (20) pyetësorë u kthyen pas si jo plotësisht të vlefshëm ndërsa njëqind e shtatëdhjetë (170) banorë nuk e plotësuan pyetësorin për arsye të ndryshme (p.sh. në banesë nuk kishte asnjë njeri në kohën e anketimit ose personat nuk pranuan të përgjigjeshin) siç u raportua dhe nga anketuesit në fletën e shënimeve të vizitave në banesa.

Një total prej dymijë (2000) pyetësorë u plotësuan dhe u konsideruan të vlefshëm për procesin e anketimit (200)- dyqind për çdo zonë të përzgjedhur.

**Tabela 1- numri i të anketuarve për zona dhe qytete**

	5 Qytete / 2 Zona / 2000 pyetësorë		
Qyteti	Zona 1	Zona 2	Total
Tiranë	200	200	400
Durrës	200	200	400
Elbasan	200	200	400
Lezhë	200	200	400
Vlorë	200	200	400
<b>Total</b>	<b>1000</b>	<b>1000</b>	<b>2000</b>

**Mosha** e personave që u përgjigjën ishte mjaft e balancuar. Në 2000 të anketuar 20.6 % e të intervistuarve ishin të moshës 18-29 vjeç; 25.4% ishin 30-39 vjeç; 27.5% ishin 40-49 vjeç dhe 26.6% ishin mbi 50 vjeç. Për sa i përket **Gjinisë** 55.6 % e personave që u përgjigjën ishin femra dhe 44.4 % ishin meshkuj. Për sa i përket **Etnisë** të personave që u përgjigjën ajo varion më së shumti nga Shqiptar, e ndjekur nga Egjiptianët, Romët dhe Grekët.

**Tabela 2- Etnia e të anketuarve për çdo qytet**

<sup>4</sup> Një bazë e plotë të dhënash me tabulimet përkatëse gjendet pranë projektit SACP

	D_10 Etnia							
	1 Shqiptar	2 Grekë	3 Arumun	4 Malazez	5 Egjiptianë	6 Maqedonas	7 Romë	8 Pa përgjigje
Tiranë	95.3%	1.0%	1.0%	.3%	.8%	.5%	.0%	1.3%
Durrës	99.5%	.0%	.0%	.0%	.3%	.0%	.3%	.0%
Elbasan	86.3%	.5%	.5%	.0%	7.3%	.0%	5.5%	.0%
Lezhë	100.0%	.0%	.0%	.0%	.0%	.0%	.0%	.0%
Vlorë	98.3%	.0%	.0%	.0%	.0%	.3%	1.5%	.0%

Për sa i takon kohës në të cilën të intervistuarit jetonin në zonat respektive ( tabela 3) 2.4% jetonin prej më pak se 6 muaj në të njëjtën zonë në kohën e intervistës, 3.0% mes 6-12 muaj ; 4.5% 1-3 vite ; 6.7% mes 3-5 vite ; 25.2% 5-10 vitë ; dhe 58.3 % jetonin prej më shumë se 10 vjetësh në të njëjtën zonë.

Prej kësaj ne mund të konkludojmë se më shumë se gjysma e të intervistuarve ishin mjaft stabil në vitet në të cilat kishin jetuar në atë komunitet në kohën e anketimit.

	D_12 – Koha që keni banuar në këtë zonë;					
	Më pak se 6 muaj	6-12 Muaj	1-3 Vjet	3-5 Vjet	5-10 Vjet	Më shumë se 10 Vjet.
1 Tiranë	3.0%	2.5%	6.8%	13.5%	42.3%	32.0%
2 Durrës	.3%	1.0%	3.3%	4.5%	39.8%	51.3%
3 Elbasan	3.8%	6.3%	6.3%	3.0%	11.8%	69.0%
4 Lezhë	2.8%	2.5%	2.3%	7.3%	17.0%	68.3%
5 Vlorë	2.3%	2.5%	4.0%	5.3%	15.3%	70.8%
Total	2.4%	3.0%	4.5%	6.7%	25.2%	58.3%

Tabela 3 - Koha që kanë banuar në atë zonë

Për sa i takon nivelit të arsimit 52.6% e të intervistuarve kishin mbaruar shkollën e mesme ndërsa 21.6% ishin me një diplomë universiteti. ( tabela 4)

	D_13 Niveli i arsimit					
	Asnjë	Filllore	9 Vjeçare	E Mesme	Universitet	Nuk e di / Jo e vleftshme
1 Tiranë	.0%	4.5%	12.3%	51.3%	31.8%	.3%
2 Durrës	.3%	6.5%	27.0%	47.3%	19.0%	.0%
3 Elbasan	9.5%	15.8%	11.8%	42.0%	21.0%	.0%
4 Lezhë	.3%	2.8%	16.5%	57.0%	16.3%	7.3%
5 Vlorë	1.5%	7.0%	6.0%	65.5%	20.0%	.0%
Totali	2.3%	7.3%	14.7%	52.6%	21.6%	1.5%

Tabela 4 - Niveli i arsimit të anketuarve

Për sa i takon **statusit të punës**, 45.1% e të intervistuarve ishin ndërkohë në punë ndërsa 55.0% ishin të papunë ose në pension. ( tabela 5)

	D_14 Punësimi – Jeni në punë	
	Po	Jo
1 Tiranë	56.0%	44.0%
2 Durrës	63.8%	36.3%
3 Elbasan	33.3%	66.8%
4 Lezhë	30.8%	69.3%
5 Vlorë	41.5%	58.5%
Totali	45.1%	55.0%

Table 5 - Niveli i punësimi

### 3.2. Rezultatet – të përgjithshme dhe specifike në pesë qytete<sup>5</sup>.

Niveli i besimit i të anketuarve në këtë anketim është 90%, që do të thotë se në qoftë se pyetjet e njëjta do të ishin kryer në popullsinë e përgjithshme të pesë qyteteve dhe jo vetëm për 2000 të anketuarit, 90% e popullsisë së përgjithshme do të ishin përgjigjur me shumë mundësi me të njëjtat rezultate mbi çështjet.

#### A. SA SERIOZE I KONSIDERONI PROBLEMET E MËPOSHTME NË ZONËN TUAJ?

Grupi i parë i pyetjeve mati se “Sa serioze i konsiderojnë një sërë problemesh banorët e zonës” në katër nivele: **Serioze / Pak serioze / Aspak serioze / Nuk e di**

##### A.1.Ndotja e Ambientit

Prej 2000 të anketuarve 46.9% e konsiderojnë atë Serioze dhe 36.6% e konsiderojnë këtë problem Pak Serioz.

Mesatarisht 83.5% e popullatës së përgjithshme e konsiderojnë ndotjen e mjedisit një problem për komunitetin e tyre.

Tirana Zona 1, Elbasani, Lezha dhe Vlora në të dy zonat e përzgjedhura në këto qytete e konsiderojnë atë si një problem në një nivel më të lartë se pjesa tjetër e zonave të anketuara.




Figure 2 - Ndotja e Ambientit sipas qyteteve

<sup>8</sup> Shih Aneksin 6 – Tabela përmblendhëse e përgjigjeve për të gjitha zonat dhe qytetet (e kuqe, jeshile, e verdhë)




Figure 3- Ndotja e Ambientit sipas gjinisë

#### A.2. Cënimi i pronës publike apo private

Prej 2000 të anketuarve, 36.6% e konsiderojnë atë si problem serioz, 29.6% e konsiderojnë atë një problem të vogël, ndërsa 30.4% nuk e konsiderojnë aspak si një problem.

Zona Tirana 1, Zona Elbasan 1, Lezha në të dyja zonat dhe Vlorë Zona 1 - e konsiderojnë atë si një problem serioz për komunitetin e tyre në një nivel më të lartë se pjesa tjetër e zonave të anketuara. Mesatarisht 66.1% e popullsisë së përgjithshme e konsiderojnë atë një problem për komunitetin e tyre.




Figure 4- Cënimi i pronës publike apo private sipas qyteteve






Figure 5 - Cënimi i pronës publike apo private sipas gjinisë

### A.3. Dehja në ambiente publike, si në rrugë, sheshe, parqe, etj.




Figure 6 - Dehja në ambiente publike sipas qyteteve

Qytetet që e konsiderojnë më shumë si një problem për komunitetin e tyre janë Elbasani dhe Lezha në të dy zonat, ndërsa mesatarisht 61.9% e popullatës së përgjithshme e konsiderojnë problem në komunitetin e tyre dehjen në ambientet publike.




Figure 7 - Dehja në ambiente publike sipas gjinisë

#### A.4 .Shpërndarja dhe përdorimi i drogës në vende publike si rrugë, parqe, shkolla, bare, etj

Nga të gjithë 2000 personat e anketuar, 26.1% e konsiderojnë një çështje serioze për komunitetin e tyre, 32.2% e konsiderojnë si pak serioze, ndërsa 31.3% nuk e konsiderojnë si problem.

Mesatarisht 58.3% e popullsisë së përgjithshme e konsiderojnë edhe këtë çështje si një problem për komunitetin e tyre. Qytetet që e konsiderojnë më shumë atë si një problem për komunitetin e tyre janë Elbasani dhe Lezha në të dy zonat, dhe zona Vlorë 1.




Figure 8- Shpërndarja dhe përdorimi i drogës në vende publike sipas qyteteve




Figure 9 -- Shpërndarja dhe përdorimi i drogës në vende publike sipas gjinisë

### A.5 .Prishja e rendit publik dhe sherret/përleshjet në rrugë

Edhe këtu mesatarisht 58.6% e popullsisë së përgjithshme e konsiderojnë si një problem dhe qytetet të cilat e konsiderojnë si problem serioz për komunitetin e tyre janë Elbasani dhe Lezha në të dy zonat e anketuara.




Figure 10 - Prishja e rendit publik dhe sherret/përleshjet në rrugë sipas qyteteve




Figure 11- Prishja e rendit publik dhe sherret/përleshjet në rrugë sipas gjinisë

### A.6. Ngacmimi i grave dhe vajzave në ambiente publike

Ndërsa kjo pyetje vetëm mat perceptimin se sa serioz të anketuarit e konsiderojnë këtë problem dhe jo nëse në të vërtetë ekziston ngacmimi i grave dhe vajzave në hapësirat publike, mesatarisht 56.3% të popullsisë së përgjithshme e konsiderojnë atë si një problem serioz.




Figure 12- Ngacmimi i grave dhe vajzave në ambiente publike sipas qyteteve




Figure 13- Ngacimi i grave dhe vajzave në ambiente publike sipas gjinisë

**A.7. Veprimtaria e bandave të të rinjve dhe & A.8. Zhurmat nga baret dhe të tjera ambiente argëtimi**




Figure 14- . Veprimtaria e bandave të të rinjve sipas qyteteve



### SACP Programme




Figure 15 - Veprimtaria e bandave të të rinjve sipas gjinisë




Figure 16 - Zhurmat nga baret, lokalet dhe të tjera ambiente sipas qyteteve




Figure 17 - Zhurmat nga baret, lokalet dhe të tjera ambiente sipas gjinisë

Mesatarisht 51.2% e popullsisë i konsiderojnë këto çështje si një problem të komunitetit të tyre. Lezha në të dy zonat e konsideron si një problem serioz për komunitetet e tyre, e ndjekur nga zona 1 e Elbasanit dhe zona 1 e Tiranës.

**A.9. Shpejtësia e lëvizjes së makinave përtej limitit të lejuar dhe A.10. Thyerja e rregullave të trafikut të tilla si mosrespektimi i dritave të trafikut, mosrespektimi i kalimtarëve, parkim i gabuar, etj.**

Mesatarisht 82.1% e të gjithë të anketuarve i konsiderojnë këto si probleme për komunitetin e tyre. Është e rëndësishme të theksohet në këtë rast **përqindja e lartë e shqetësimit për këto çështje në zona specifike** si Lezha ku 100% e të anketuarve i konsiderojnë këto probleme si serioze, ndjekur nga Vlora me 98.5% të popullsisë në zonën 1 dhe Elbasan 97.5% në zonën 1.

## B. EKSPOZIMI NDAJ KRIMIT

Grupi i dytë i pyetjeve u përqëndrua në pyetjet nëse gjatë 12 muajve të fundit të anketuarit kishin qënë personalisht viktimë e krimit dhe dhunës fizike duke iu përgjigjur pyetjeve që adresonin nëse ata kishin qënë:

- ❖ Viktimë e dhunës fizike
- ❖ Viktima e vjedhjes
- ❖ Viktimë e cënimit të pronës
- ❖ Viktimë e veprimeve të tjera kriminale

Është e rëndësishme të theksohet se **gjatë 12 muajve të fundit, 72 të anketuar u përgjigjën të kenë qënë viktima të dhunës fizike ose 3.6% e popullsisë së përgjithshme** me normat më të larta në zonën 1 Durrës, Elbasan zona 2, Tirana të dy zonat. Është e paqartë nëse pjesa tjetër e zonave të tilla si Lezha dhe Vlora nuk përballen me një problem të tillë apo nëse nuk janë ndjerë të gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla. Këto përgjigje mund të jenë të lidhura edhe me faktin që **39% e të anketuarve** të cilat pranuan të ketë qënë viktimë e dhunës fizike, thanë që kjo ka ndodhur brenda banesës së tyre (Pyetja – Ku ndodhi kjo gjë?).




Figure 18 - Viktimë e dhunës fizike






Figure 19 - Viktimë e dhunës fizike - Nëse PO, Ku ndodhi?




Figure 20 - Viktimë e vjedhjes




Figure 21 - viktimë e cënimit të pronës

322 të anketuar raportuan se kanë qenë **viktimë e vjedhjes / grabitjes (16.1%) nga të cilët 33.2% e këtyre rasteve ndodhën pranë ose brenda banesës së tyre**. Zona Lezha 2 ka numrin më të lartë të të anketuarve që e pohojnë këtë gjë, pasuar nga zona 1 e Elbasanit dhe zona 2 e Durrësit.

212 të anketuar kanë raportuar që **kanë viktimë të cënimit të pronës (10.6%)** me 55.7% të rasteve të raportuara të ndodhura në shtëpitë e tyre dhe 15.6% në makinat e tyre apo motorët. Zona Lezha 2 ka normat më të larta të raportimit të rasteve të tilla ndjekur përsëri nga e zona 1 e Lezhës dhe Durrësi në të dy zonat.

102 anketuar kanë raportuar të ketë qenë **viktimë e veprave të tjera kriminale** ose 4.4% të totalit të të anketuarve.

### B.1. Frekuencat në përgjigjet e dhëna

1590 persona janë përgjigjur me **JO për katër pyetjet** që kanë të bëjnë me rastet e të qenit viktimë.

200 persona janë përgjigjur me **PO vetëm për një nga katër pyetjet** që kanë të bëjnë me rastet e të qenit viktimë.

136 persona janë përgjigjur me **PO në dy nga katër pyetjet** që kanë të bëjnë me rastet e të qenit viktimë.

60 persona janë përgjigjur me **PO në tre nga katër pyetjet** që kanë të bëjnë me rastet e të qenit viktimë.

14 persona janë përgjigjur me **PO në katër nga katër pyetjet** që kanë të bëjnë me rastet e të qenit viktimë.

Është e pamundur për të identifikuar nëse të anketuarit janë përballur vetëm me një krim dhe e kanë raportuar atë në disa pyetje (për shembull se kanë patur vetëm cënim të pronës apo në të njëjtën kohë ata kanë qënë edhe viktimë e dhunës fizike dhe vjedhjes, pra viktimë e disa veprave kriminale në të njëjtën kohë).

### B.2. Raportimi tek policia lidhur me krimet dhe dhunimet

87 persona janë përgjigjur se kanë raportuar aktet kriminale në polici, nga të cilët 70 persona kanë raportuar çdo vepër penale që ata kanë qënë viktimë, ndërsa 17 persona kanë raportuar vetëm një apo disa nga rastet.




Figure 22 - Gjatë 12 muajve të fundit a keni raportuar në polici ndonjë veprim kriminal ndaj jush?

Kur kanë raportuar në polici, 58 nga të anketuarit konfirmojnë se policia ka kërkuar një deklaratë apo një raport me shkrim për të gjitha rastet të cilat ato kanë raportuar; 18 u përgjigjën se policia ka kërkuar një deklaratë apo një raport me shkrim për një ose disa nga çështjet që ata kanë raportuar **ndërsa 11 konfirmojnë se policia nuk ka kërkuar ndonjë deklaratë ose raport me shkrim (8 raste kanë qenë në Lezhë).**





Figure 23 - A ju kërkoi policia deklarate apo kallëzim me shkrim në këto raste që raportuat?

## C.SHQETËSIMET LIDHUR ME SIGURINË DHE RENDIN NË KOMUNITETIN E TYRE DHE ZONAT KU BANOJNË


Në këtë grup pyetjesh, të anketuarit janë pyetur lidhur me shqetësimet që mund të kenë hasur në lidhje me çështjet e sigurisë gjatë 12 muajve të fundit. Pyetja ishte:

Gjatë 12 muajve të fundit, a jeni ndjerë i shqetësuar se:


**C1. Dikush mund të hyjnë me forcë për të vjedhur në banesën tuaj?** - 38.15% e të anketuarve e konsiderojnë si një problem.



**C2. Ju mund të jeni një viktimë e krimit në hapësirat tuaja të banimit të përbashkëta të tilla si shkallët, ashensori, ose garazhi? - 36.45% e të anketuarve e konsiderojnë këtë si një problem.**




**C3. Dikush mund të vjedhë apo të dëmtojë makinën tuaj, biçikletën parkuar pranë zonës tuaj të banimit? - 41% e të anketuarve e konsiderojnë si një problem.**






C4. Mund të jeni viktimë e dhunës në zonën pranë banesës tuaj? – 37.5% e konsiderojnë si një problem.



C5. A keni qenë të shqetësuar për sigurinë e fëmijëve tuaj në zonën tuaj të banimit? - Më shumë se gjysma e të anketuarve 58.9% janë përgjigjur që janë të shqetësuar për sigurinë e fëmijëve të tyre në zonat e tyre të banimit.




Siç vini re nga grafikët më sipër, në Lezhë ka një përqindje shumë e lartë e të anketuarve që tregojnë shqetësim në lidhje me sigurinë e tyre dhe rendin në zonën rezidenciale të banimit. Këto shifra ndiqen nga Elbasani.

#### D. PERCEPTIMI I FRIKËS DHE PASIGURISË


Në këtë grup pyetjesh të anketuarit u pyetën nëse ata kanë shmangur disa aktivitete rutinë për shkak të frikës apo pasigurisë që mund të ndjejnë në komunitetet e tyre:

**D.1. Si ndiheni kur ju ecni në errësirë në zonën pranë banesës suaj?** – 27.3% e totalit të të anketuarve përgjigjen se ndihen të pasigurtë dhe sipas zonave këtë shqetësim e paraqesin më shumë Durrësi në të dy zonat, zona 2 në Tiranë, zona 1 në Elbasan dhe zona 1 në Vlorë.



**D2. A keni frikë nga një përsone i veçantë në zonën tuaj të banimit?** – 18.7% e totalit të të anketuarve ndjehen të frikësuar prej dikujt në zonën e tyre të banimit. 9.5% kanë frikë nga një person dhe 9.2% kanë frikë nga më shumë se një person në zonat e tyre. Shumica e këtyre përgjigjeve vjen nga zona 1 në Durrës (42% e të anketuarve janë përgjigjur që kanë frikë) dhe zona 2 në Elbasan (56% e të anketuarve).





**D.3 Gjatë 12 muajve të fundit, a keni shmangur pjesëmarrjen në veprimtaritë e mëposhtme për shkak të pasigurisë apo frikës që ju mund të abuzoheshit / keqtrajtoheshit ose të ishit viktimë e vjedhjes / dhunës?**

1. Aktivitetet sportive
2. Frekuentimin e kinemasë, teatrit, apo veprimtari të tjera artistike dhe kulturore
3. Frekuentimin e bareve, restorante apo vende të tjera argëtuese
4. Pjesëmarrjen në aktivitete publike
5. Përdorimin e transportit publik




Figure 24 - Gjatë 12 Muajve të fundit keni evituar pjesëmarrjen në aktivitete publike

Mesatarisht 13.1% e të gjithë të intervistuarve janë përgjigjur se kanë shmangur katër aktivitetet e para për shkak të pasigurisë, ndërsa vlen të përmendet **shkalla e lartë e përgjigjeve prej pasigurisë për përdorimin e transportit publik** (33% e totalit të anketuarve) me normat e larta të pasigurisë në të dy zonat e Lezhës (68.5% e të anketuarve) ndjekur nga zona 2 Elbasanit (48.5%) dhe zona 1 e Vlora (35%) - Figura 25.




Figure 25- Gjatë 12 muajve të fundit sa jeni ndier të pasigurt në përdorimin e transportit publik?

## E. KËNAQËSIA ME PUNËN E POLICISË NË KOMUNITET


Në këtë grup pyetjesh, pjesëmarrësit iu përgjigjën pyetjes:

E.1. A jeni dakort me deklaratën: "**Policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën time të banimit**" – e matur në katër nivele (Jam shumë dakort, Jam dakort, Nuk jam dakort dhe Nuk jam fare dakort).

E.2. Është interesante të vërehet se 51.5% e popullsisë së përgjithshme bie dakort me këtë deklaratë, ndërsa 48.5% nuk pajtohet me deklaratën. Shumica e të intervistuarve që pajtohen me këtë deklaratë janë në Tiranë në të dy zonat, Durrës në dy zonat dhe zonën 1 në Vlorë të cilët tregojnë që kanë një përqindje më të lartë të besimit në punën e policisë. Ndërsa Lezha në të dy zonat, zona 2 në Vlorë dhe zona 2 në Elbasan kanë nivelin më të ulët të besimit në punën e policisë dhe nuk janë dakort me këtë deklaratë. (Fig 26



Figure 26 - Sa jeni dakort me pohimin se policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën tuaj të banimit?



E.3. Pjesëmarrësit u pyetën gjithashtu nëse **"Gjatë 12 muajve të fundit kanë pasur ndonjëherë ndonjë kontakt me policinë?"** – 285 persona u përgjigjën që kanë pasur kontakte me policinë (14.3%) dhe nga ky numër 28.1% i kanë pasur këto kontakte në ambientet e policisë, ndërsa 71.9 % i kanë pasur kontaktet jashtë ambienteve të policisë.




Figure 27 - Keni pasur kontakte me policinë




Figure 28 - Ku jeni takuar me policinë

A ndihen qytetarët e anketuar:	Niveli Kombetar	Tirana		Durrësi		Elbasani		Lezha		Vlora		Mesatarja	Kufiri me i Ulet	Kufiri me i larte
		Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2	Zona Pilot 1	Zona Pilot 2			
Q_16.1 Policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën time të banimit: <b>DAKORT</b>	51.5	72.5	66.5	69.0	82.0	50.5	48.0	13.5	3.0	78.5	31.5	51.5	49.7	53.3
Q_16.2 Policia kujdeset për problemet e rendit publik në zonën time të banimit: <b>Jo-DAKORT</b>	48.5	27.5	33.5	31.0	18.0	49.5	52.0	86.5	97.0	21.5	68.5	48.5	46.7	50.3
Q_19.1 Të pakënaqur nga kontaktet personale me policinë *	39.6	21.1	30.0	48.4	32.5	40.7	.0	60.9	76.9	40.5	26.5	39.6	34.9	44.4
Q_19.1.1. Të kënaqur nga kontaktet personale me policinë *	36.8	57.9	50.0	22.6	50.0	29.6	50.0	21.7	7.7	40.5	44.1	36.8	32.1	41.6
Q_19.2 Të pakënaqur nga kontaktet personale me policinë **	5.7	2.0	1.5	7.5	6.5	5.5	.0	7.0	10.0	7.5	9.0	5.7	4.8	6.5
Q_19.2.1 Të kënaqur nga kontaktet personale me policinë **	5.3	5.5	2.5	3.5	10.0	4.0	1.0	2.5	1.0	7.5	15.0	5.3	4.4	6.1

Tabela 6 - ( Q19.1 dhe Q19.2 Sa të kënaqur kanë qenë nga kontaktet me policinë)

Në tabelën 6 - Q19.1 dhe Q19.1.1 (\* Konsideruar vetëm personat që kanë pasur kontakt me policinë) dhe Q19.2 dhe Q19.2.1. (\*\* Konsideruar përqindjen sipas raportit me të gjithë personat e anketuar)

**E.3.1. Figura 28 na jep informacion mbi ku kanë ndoshur kontaktet me policinë të vetëm personave që kanë patur kontakte me policinë.**

**Nga personat që kanë pasur kontakte me policinë ( tabela 6) na tregon se 39.6% ishin të pakënaqur nga kontaktet e tyre me policinë (ose 5.7% e gjithsej 2000 të intervistuarve) (zona 1 Durrës, zona 1 Vlorë dhe Lezha të dy zonat) dhe 36.8% e personave, që kanë pasur kontakte me policinë ishin të kënaqur nga kontaktet e tyre me policinë (ose 5.3% e gjithsej 2000 të intervistuarve). (Tirana dy zonat, zona 2 në Durrës, zona 2 në Elbasan dhe zona 2 në Vlorë)**

## SHTOJCA

### 1.METODOLOGJIA

#### 2.1. Përcaktimi i kampionit të anketimit – qasja e anketimit personal në banesë

Përzgjedhja e personave në këtë anketim u mbështet në metodën e “anketimit personal në banesë”. Anketimi u realizua në 5 qytete: Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Lezhë – dy zona të përcaktuara në çdo qytet (10 zona në total).

Një numër prej 200 intervistash u përcaktua për t’u plotësuar në çdo zonë, pra në total anketimi përmban 2000 intervista të vlefshme.

Kompania mori nga ekipi i Projektit SACP një listë të zonave ku përcaktoheshin kufijtë e secilës zonë dhe numri i përafërt i popullsisë për çdo zonë.<sup>6</sup> “Zonat” janë pjesë e qyteteve të mësipërme dhe kanë mesatarisht 10.000-12.000 banorë. Këto të dhëna nuk e përmbanin numrin e banesave dhe as llojin e banesës (p.sh. apartament, shtëpi, etj).

Realizimi i suksesshëm i një anketimi të tillë në banesë kërkon një njohje të mëparshme të zonës së studimit dhe të popullsisë të asaj zone. Përpara fillimit të studimit dhe me përcaktimin e secilës zonë të përzgjedhur ekipi i studimit ndërmori këto hapa:

- Prgatiti harta të detajuara për çdo qytet për të lokalizuar zonat dhe harta të detajuara për çdo zonë<sup>7</sup>,
- U takuan anketuesit për të shpjeguar zonat dhe u kërkoi atyre si hap të parë të realizimit të anketimit një raport që përmbante lokalizimin e banesave, llojin, dendësinë (p.sh. 3 pallate nga 6 kate, rrugë me shtëpi private, etj),
- Çdo anketuesi iu dhanë gjithashtu kontaktet e policisë së zonës me qëllim për t’i kontaktuar në rast se do të kishin nevojë për ndihmë në identifikimin e zonave dhe rrugëve.

Për të minimizuar gabimin në përzgjedhjen e banesave, banesa e parë për t’u vizituar u përcaktua në mënyrë të rastësishme. Pasi u njohën me zonat dhe shtëpitë, anketuesve iu kërkua t’i caktojnë një numër (1-10) çdo banese dhe të zgjidhnin banesën e parë në bazë të llogaritjes së atij numri nga pika e fillimit të anketimit tek banesa e parë. Intervali i kampionimit u përdor në vazhdim për të përzgjedhur banesat e tjera vijuese.

Gjatë anketimit u morën të gjitha masat për të përfshirë të gjitha banesat e përzgjedhura. Anketuesit u udhëzuan që nëse një shtëpi ishte pa njerëz në kohën e vizitës, ajo shtëpi do të ri-

<sup>6</sup> Aneksi 1 – Lista e qyteteve dhe shpjegimi i zonave

<sup>7</sup> Aneksi 2 – Hartat e qyteteve dhe zonave

vizitohej më vonë atë ditë ose në ditën tjetër. Nëse shtëpia ishte e pabanuar prej kohësh, apo nëse banorët do refuzonin të merrnin pjesë, ose nëse një i rritur nuk ishte i disponueshëm për intervistë edhe pas dy përpjekjesh, atëherë do të përzgjidhej banesa tjetër më e afërt. Çdo anketuesi iu kërkua që të përpiqej të kontaktonte me të njëjtën banesë dy herë përpara se të shkonte tek banesa tjetër më e afërt. Numrin e banesave të padisponueshme dhe arsyen anketuesi e shënonte në Fletën e Banesave të Vizituara<sup>8</sup> e cila i dërgohej përditë Koordinatorit Lokal të Anketimit.

Një trajnim dy ditor u realizua për anketuesit në Tiranë sipas një programi që përmbante:

- ❖ Ushtrime interaktive për t'u mësuar anketuesve se si t'u përgjigjeshin pyetjeve që mund të kishin të anketuarit, si të krijonin një raport besueshmërie me ta dhe të fitonin bashkëpunimin e tyre,
- ❖ Shpjegimin e Formatit të Marrjes së Miratimit, i nevojshëm për të siguruar pjesëmarrjen e lirë të të intervistuarve, për t'i ndihmuar ata të kuptonin që duke rënë ose jo dakort për të marrë pjesë në anketim ishte një zgjedhje vullnetare dhe gjithashtu të kuptonin qëllimin e anketimit në lidhje me angazhimin e tyre dhe ruajtjen e anonimatit të përgjigjeve<sup>9</sup>,
- ❖ Përshkrimin e anketimit, përse po realizohet dhe si do të përdoret informacioni që do të mblidhet,
- ❖ Termat e referencës dhe pritshmëritë nga anketuesit e kontraktuar, (të drejtat dhe detyrat e anketuesit/anketuesit duke përfshirë këtu çështjet e konfidencialitetit gjatë procesit dhe pas tij),
- ❖ Rishikim i çdo pyetje të pyetësorit për të konfirmuar që ato ishin të përshtatshme dhe të kuptueshme nga banorët dhe sa të qarta ishin edhe për anketuesit,
- ❖ Rishikim i Formatit të Marrjes së Miratimit,
- ❖ Rishikim i metodës së përzgjedhjes së banesave,
- ❖ Rishikim i gjithë dokumentacionit dhe Fletës së Vizitave të Banesave ku do të regjistroheshin rezultatet e vizitave.

## 2.2. Pyetësi i anketimit

Pyetësi i anketimit u bazua në Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet (LSMS) i cili përdoret për të matur nivelin e sigurisë si dhe kënaqësinë me punën e policisë në zona të vogla dhe të mirëpërcaktuara.

<sup>8</sup> Aneks 4 – Fleta e Banesave të Vizituara (në Shqip dhe anglisht)

<sup>9</sup> Aneks 5 – Formatit i marrjes së miratimit në shqip

Ky pyetësor i mbështetur në termat e referencës së programit u përpunua duke marrë parasysh kontekstin lokal dhe duke shtuar pyetjet demografike<sup>10</sup>.

### 2.3. Mbledhja e të dhënave dhe hedhja e tyre në programin SPSS

Anketuesit e zhvilluan punën në terren sipas një plani pune të paracaktuar dhe një formati të përditshëm raportimi. Puna e tyre u mbështet, koordinua dhe u mbikqyr nga koordinatorët lokalë.

Për hedhjen e të dhënave u përdor Programi SPSS. Të dhënat u hodhën përditë, në mënyrë që çdo çështje apo paqartësi që dilte gjatë hedhjes së të dhënave të mund të adresohet ndërkohë që anketimi ishte në proces. Ky informacion ditor iu dërgohej ekspertëve të hedhjes së të dhënave.

**Hedhja e të dhënave:** Programi i përdorur për krijimin e aplikacionit për përpunimin e të dhënave u prodhua në CPro<sup>11</sup> versioni 4.1. Ky aplikacion përmbante formularë për hedhjen e të dhënave, komandat e kontrollit dhe komandat për kalimin e pyetjeve në rastet kur i anketuari përgjigjej “jo”, sipas formatit të pyetësorit. Shumica e variablave të pyetësorit ishin të përcaktuara me rangje. Vetëm vlerat brenda rangjeve të specifikuara mund të hidheshin. Kjo bëri të mundur të ulej mundësitë e gabimeve në hedhjen e të dhënave. Programi i ndërtuar specifikisht për këtë pyetësor kishte edhe disa komanda kontrolli, të tilla si kontrolli strukturor dhe kontrolli i përmbajtjes. Supervizorët që kontrollonin pyetësorët e plotësuar siguroheshin që të gjithë pyetësorët të ishin të mbushur në mënyrë të saktë për t’u hedhur në bazën e të dhënave.

**Procesimi i të dhënave:** Procesimi i të dhënave u bë nëpërmjet programit SPSS. Eksportimi i të dhënave të hedhura nga Aplikacioni i Hedhjes së të Dhënave në dosjet e SPSS kryhej automatikisht nga sistemi i CPro. Përpara përdorimit të skedarit të të dhënave, u shtuan dhe vlerat e variablave dhe etiketimi i vlerave të tyre. Një etiketim i variablit përshkruan subjektin e tij dhe etiketimi i vlerës përshkruan çfarë përfaqëson secila vlerë e variablit. Kur etiketat dhe variablat u shtuan në këtë skedar të SPSS dhe u vendosën variablat që do të analizoheshin atëherë u krijua dokumenti final me analizat e rezultateve. Programet e tabulimit i përdorën këto skedarë të dhënash për të krijuar tabelat e rezultateve.

**Gabimet që mund të vinin jo për shkak të kampionimit** – Përveç kampionimit, edhe të tjerë faktorë mund të sillnin gabime në rezultatet e studimit. Të anketuarit mund të keqkuptonin pyetjet dhe t’iu përgjigjeshin atyre në mënyrë të pasaktë, ose përgjigjet mund të hidheshin gabim gjatë hedhjes së të dhënave dhe procesimit të tyre. Gjatë këtij anketimi u morën masa që të minimizoheshin efekte të tilla si edhe u realizua trajnimi i anketuesve. Trajnimi u organizua për t’u siguruar që të gjithë anketuesit si dhe anëtarët e tjerë të projektit të kishin një kuptim të njëjtë dhe

<sup>10</sup> Aneks 3 – Formatit i pyetësorit në shqip dhe në anglisht

<sup>11</sup> Census and Survey Processing System, IPC. U.S. Census Bureau

të saktë mbi anketimin në përgjithësi, qëllimet specifike të tij dhe thelbin e përmbajtjes së këtij anketimi.

**Testimi paraprak i pyetësorit** – Një test paraprak u realizua në Tiranë për të testuar fjalitë, rrjedhën e anketimit, elementet e shmangies ndaj përgjigjes, lehtësimin në administrim, kuptimin e pyetjeve të anketimit nga ana e personave që përgjigjen, dhe të tjerë faktorë që lidhen me vetë instrumentin e përdorur.



## 2.– LISTA E QYTETEVE DHE SHPJEGIMI I ZONAVE

### **Tirana Zona 1**

Lagjia Nr. 10: Rr Fadil Rada, rr. Tefta tashko, Sheshi Avni Rustemi, Bul. Zhan D'ark, Bul. Dëshmoret e Kombit, rruga e Dibrës, rr. Qemal stafa

### **Tirana Zona 2**

Njësia bashkiake Nr. 2, Sauk, Komuna farke, Zona e liqenit artificial, Rr. Fuat Toptani, Rr. E Elbasanit, Rr. Gjeneral Nikola.

### **Vlora Zona 1**

Lagjja “Lef Sallata”, “Rilindja”, “Pavaresia 3”

### **Vlora Zona 2**

Lagjja “Isa Boletini”, “Pavaresia”

### **Durres Zona 1**

Lagjia Nr.15

### **Durres Zona 2**

Lagjia 1 Vollga, pjese e Njesia Administrative Nr.1

### **Lezha Zona 1**

Lagjia “Beslidhja”

### **Lezha Zona 2**

Komuna Shenkoll

### **Elbasan Zona 1**

Lagjja Kala dhe Lagjja “Aqif Pasha”

### **Elbasan Zona 2**

Lagjja 5 maji

### 3- HARTAT E QYTETEVE DHE ZONAVE

#### TIRANA




Figure 29 - Harta e Tiranës me 2 zonat




Figure 30 - Tirana Zona 1




Figure 31 - Tirana Zona 2

## DURRËSI



Figure 32 - Harta e Durrësit me 2 Zonat





Figure 33 - Durrës Zona 1



Figure 34 - Durrës Zona 2

LEZHA




Figure 35 - Harta e Lezhës me 2 Zonat



Figure 36 - Lezha Zona 1



Figure 37 - Lezha Zona 2

## VLORA




Figure 38 - Harta e Vlorës me 2 Zonat





Figure 39 - Vlorë Zona 1




Figure 40 - Vlorë Zona 2

ELBASANI



Figure 41- Harta e Elbasanit me 2 Zonat




Figure 42 - Elbasan Zona 1





Figure 43 - Elbasan Zona 2